



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE UNIFORMA PËR CEREMONI DIPLOMIMI”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 18110000-3

REF-59467-08-27-2025

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,606,728.8 (dy milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e tetë pik tetë) **lekë pa tvsh** e ndarë si më poshtë:

- **Vlera e Fondit limit pa tvsh për Fakultetin e Mjekësisë Dentare: 299,906.4** (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtë pik katër) **lekë pa tvsh.**

- **Vlera e Fondit limit pa tvsh për Fakultetin e Mjekësisë: 2,006,270.4** (dy million e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë pik katër) **lekë pa tvsh.**

- **Vlera e Fondit limit pa tvsh për Pelerinat dhe kapelet me xhufkë për profesorët (Senatin akademik): 300,552** (treqind mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) **lekë pa tvsh.**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedurë prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertes është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mesipercituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk duhet të jetë më e vogël se 15% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi **deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, duke gjykuar të arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet ekonomike dhe financiare të OE. Në këtë mënyrë AK krijon bindjen e përgjithshme për aftësinë e OE për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Duke qenë një kontratë e rëndësishme me veshje speciale të nevojshme për studentët, kërkohet vlera maksimale e lejuar.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet na AK në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila nuk është me e madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar te arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE. Përcaktimi i vlerës së sipërcituar për furnizimet e mëparshme të ngjashme është një kriter i thjeshtësuar pranimi nga AK me qëllim nxitjen e pjesmarrjes dhe të Operatorëve të rinj në treg. Në këtë mënyrë AK krijon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar

në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” ” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ne te cilen gjejmë të përcaktuar se: 4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qellim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht materiale që plotësojnë

kërkesat e AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së , na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, pra ky standard mundëson menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimin e konformitetit duke rritur performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues, kështu që mallrat e furnizuara të jenë të sigurta dhe të cilësisë së mirë. ISO duhet të jetë në emër të shoqërive dhe në objektet e certifikatës duhet të ketë lidhje me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të gjithë artikujve dhe të realizojë në aftin e kërkuar objektin e prokurimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e artikujve objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor, brenda afatit kohor kur te nënshkruhet kontrata.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat për zërat e kërkuara, për të provuar pajtueshmërinë me specifikimet teknike të vendosura në shtojcën 6. Dorëzimi i mostrave do të bëhet në ambientet e UMT-së, në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Mostrat e kërkuara do të dorëzohen në ditën e hapjes së procedurës nga OE pjesmarrës në procedure në orën 11:00 si dhe do të mbahet procesverbal në të cilin do të dokumentohet procesi i paraqitjes së mostrave duke pasqyruar detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Shënim: Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është kërkuar bazuar në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 162, datë 23.11.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, neneve 2, në pikën 6 të Nenit 40 dhe 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (në vijim "VKM"), i ndryshuar VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave”, sipas së cilës: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, Mostrat trajtohen si informacion konfidencial dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”.*

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK se mallrat që do të furnizojë do të jenë cilësore, pra lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë cilësinë e mallrave të ofruara. Kështu AK, kërkon që OE të paraqesë, jo më vonë se data dhe ora e hapjes së ofertave, për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, nga një moster fizike, pasi është domosdoshmëri për të gjykuar nëse mallrat që do të ofrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe operatori fitues do të furnizojë me ato mallra identike që ka paraqitur ditën e tenderit dhe për të cilat do të jetë shpallur fitues. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së materialit të produktit final, dizenjimin e, dimensionet e kërkuara, si dhe karakteristika të tjera që lidhen me aksesoret që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumentave të tjerë të kërkuara. Mosparaqitja është kusht për skualifikim.

2.3.5 Operatori ekonomik për artikujt objekt prokurimi, duhet të paraqesë Çertifikatë OEKO-TEX (standarti 100) ose ekuivalente me to, të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstile, e shoqëruar me autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit (ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin), me të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit që e ka lëshuar këtë dokument, si: telefoni/e-mail/website, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, gjithashtu, për të vertetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX (standarti 100) ose ekuivalente, duhet që operatori ekonomik të paraqesë certifikatën OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të vlefshme të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi. OEKO-TEX® standard 100 është një sistem testimi dhe certifikimi i njohur në të gjithë botën për lëndët e para, të ndërmjetme dhe të përfunduara të tekstileve përgjatë gjithë hapave të prodhimit, për të garantuar që produktet e tekstit të mos jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut, pasi çdo komponent i një produkti, që nga lënda e parë (metrazhi) e deri te aksesoret, duhet të jetë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës së tekstit natyror është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

Me qëllim identifikimin e operatorëve ekonomik të cilët janë të autorizuar për shitjen e produkteve objekt të këtij prokurimi dhe lidhjen mes OE dhe prodhuesit. Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit. OEKO-TEX® standard 100 është një sistem testimi dhe certifikimi i pavarur në të gjithë botën për produktet tekstile të papërpunuara, gjysëm të gatshme dhe të përfunduara në të gjitha nivelet e përpunimit, si dhe materialet ndihmëse të përdorura. Shembuj të artikujve që mund të certifikohen: fije të papërpunuara dhe të lyer / të përfunduara, pëlhura të thurura dhe të thurura, pajisje, të tilla si butona, fasteners zinxhir, temat e qepjes ose etiketat, artikuj të gatshëm të llojeve të ndryshme (veshje të të gjitha llojeve, tekstile, liri krevat, produkte të mëndafshit dhe shumë më tepër.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 3 (tre) persona për muajin e fundit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, 2 prej ketyre të jenë rrobaqepës/se. Dokumenti që duhet të paraqitet nga operatori ekonomik fitues, përpara**

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, është vërtetimi/listepagesa lëshuar nga Administrata Tatimore/Sigurimet Shoqërore dhe kontrata e punës.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomikë do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme, për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllëgoaritur si më poshtë:

Gjykojmë se është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të mjaftueshëm prej 3 (tre) të punësuar, mbështetur në zërat sipas tabelave me specifikimet teknike dhe natyrën e tyre. Duke qenë afati i ekzekutimit i shkurtër **prej 15 ditësh**, kërkesa prej 3 punonjësish që do të përfshihen dhe që do të jenë të gatshëm në çdo kohë të zbatimit të kontratës, justifikohet me personat e nevojshëm të cilët do të angazhohen 1 (një) në procesin e porosisë dhe magazinimit , procesin e transportit dhe shpërndarjes së mallrave, dhe të paktën 2 rrobaqepësit të cilët janë një numër minimal bazuar në afatin kohor për zbatimin e kontratës të cilët do merren me prerjet, qepjet sipas specifikimeve të kërkuara me qëllim realizimin e kontratës në afat dhe me cilësi.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve për muajin e fundit, që është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, për sa kohë që është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Sa më sipër, është e nevojshme që OE duhet të ketë në stafin e tij numrin e punonjësve të kërkuar nga AK, për të mundur përmbushjen në kohë të kontratës.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” bazuar në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik të përqëndruara për vitin 2025 të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe kërkesave të Fakulteteve, përkatësisht Specifikimet teknike janë hartuar sipas: shkresës së Fakultetit të Mjekësisë nr. 1650/2 Prot., datë 07.08.2025, protokolluar pranë UMT-së me nr. 180/39 Prot., datë 07.08.2025, shkresës së Fakultetit të Mjekësisë Dentare nr. 27/16 Prot., datë 12.08.2025, protokolluar pranë UMT-së me nr. 180/40 Prot., datë 12.08.2025 , shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse nr. 180/42 Prot., datë

14.08.2025 si dhe shkreses së Rektorit për antarët e Senatit Akademik nr.180/41 prot., datë 12.08.2025;

Për Fakultetin e Mjekësisë (FM):

Nr	Emërtimi i Mallit	Njësi	Sasia
1	Pelerina për ceremoni diplomimi për student	Copë	388
2	Kapele me xhufkë për ceremoni diplomimi për student	Copë	388

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Tabela Nr 1

Nr	Përshkrimi i mallrave	Specifikime Teknike	Njësia	Sasia
1	Pelerina për Ceremoni diplomimi për student	- Materiali i pelerinës duhet të jetë atlas 100% poliestër. - Pesha e materialit që do të përdoret duhet të jetë 180 gr/m². - Përmasat duhet të jenë S-M-L-XL (sipas tabelës së mëposhtme Nr 2). - Ngjyra pelerinës do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. - Pelerina duhet të jetë model monopet, pa astar nga brenda dhe përpara të mbyllet me zinxhir. Në bel duhet të jetë e lirshme. Pjesa e përparme të ketë supanjë me copë dopio dhe thellësi 23 cm nga pika më e lartë e supit. Pjesa e përparme të ketë dy pala me gjërësi 5 cm e cila aplikohet tek pjesa e bashkimit me supanjën. Gjithashtu pjesët e përparme, duke filluar nga lart të mbyllen me zinxhirin me dhëmbëza plastike sipas ngjyrës së pelerinës dhe me gjatësi 55-60 cm. - Në të gjithë gjatësinë e saj, pelerina të ketë një imitim shall, i cili e përshkon atë në gjithë gjatësinë e saj. Gjerësia e shallit duhet të jetë 10 cm. Në pjesën e jashtme shalli duhet të qepet në trupin e pelerinës. Në pjesën e pasme shalli duhet të përfundojë me një trekëndësh, me një gjatësi 10 cm nga qepja e jakës. Shalli duhet të jetë i fiksuar në pjesët e përparme të pelerinës me një tegel me një gjilpërë. Ngjyra e shallit duhet të jetë e njëjtë me atë të xhufkës, e cila do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. - Shpinës së pelerinës do t'i aplikohet gjithashtu një supanjë me copë dopio. - Pala e pelerinës në fund, duhet të dalë e mbaruar 2 cm. - Shpina, mëngët dhe gjokset, duhet të bashkohen me makinë me syzator. Gjatë procesit të bashkimit duhet bërë kujdes për të mos krijuar diferenca në gjatësinë e gjokseve. - Mëngët duhet të jenë një copëshe dhe bashkimi i tyre me trupin duhet të realizohen duke filluar nga bashkimi i pjesëve të shpinës me gjokset. Bashkimi i tyre (mëngëve) duhet të bëhet me makinë një gjilpërëshe. Për të patur një bashkim të fortë, të ngritur dhe të	Cope	388

		harkuar bukur të mëngëve me trupin e pelerinës duhet që thellësia e rrethit të sqetullës të përputhet me thellësinë e mëngës. Bashkimi i mëngëve me trupin e pelerinës duhet të jetë simetrik. Bashkimi duhet të bëhet pa rrudha dhe të mos formojë tërheqje. Mëngët duhet të jenë të tilla që të krijojnë lehtësi në përdorim dhe estetikë në paraqitje. Mbylljet e mëngëve dhe e gjoksit me shpinën për një fiksion sa më të mirë të tyre duhet të realizohen me makinë dygjilpërëshe nga ku përfitohet tegel dysh zbukurimi. Mbyllja e pelerinës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe vazhdon me mbylljen e mëngëve. Pelerina e ceremonisë së diplomimit duhet të jetë simetrike në të gjithë elementet e saj. Ajo në model është e njëjtë si për meshkuj ashtu edhe për femra. • Tegelat duhet të jenë të fortë, uniformë, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rregullt dhe të drejtë. Tegelat duhet të jenë të fortë në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë i fortë dhe i njëjtë me ngjyrën e tekstilit të pelerinës me Nm80/2 100%PES.		
2	Kapele me xhufkë për ceremoni diplomimi për studentë	• Materiali i kapeleve të diplomimit për studentët, duhet të jetë material atllas, 100% poliestër. • Pësia e materialit që do të përdoret duhet të jetë 180 gr/m². • Kapelja duhet të përbëhet me tre elemente:- Syprina që mbulon pjesën e sipërme të kokës së përdoruesit. Përmasat e saj duhet të jenë 25 cm x 25 cm. Në brendësi të tekstilit duhet të futet një material i fortë dhe i lehtë (karton, plastike) me përmasat e mësipërme dhe i mbuluar me qëllim që të ruajë formën e një syprine katërkëndore. – Cilindri, pjesa e cilindrit që rrethon pjesën anësore të kokës në ekstremin e sipërm lidhet me pjesën katërkëndore, ndërsa në ekstremin e poshtëm qepet një llastik i maskuar me tegel, në mënyrë që të jetë e përshtatshme për çdo përmasë të kokës së përdoruesve. Përmasat e cilindrit të kapeles duhet të jenë unike, në proporcion me pjesën katërkëndore (diametër 20 cm, lartësi 12 cm). Bashkimi i tekstilit me materialin e fortë (karton plastike), duhet të jetë në mënyrën më të mirë të mundshme, me ngjitje ose me qepje. – Xhufka, në mes, kapeles i vendoset një buton, i përbërë nga materiali i kapeles, pas të cilit qëndron e lidhur një xhufkë me fije, ngjyra e të cilës do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. • Materiali që do të përdoret për xhufkat do të jetë: - me fije sintetike me trashësi 2 mm - gjatësia e xhufkës do të jetë 22cm - gjatësia e fijes së mbërthimit të xhufkës me kapelen duhet të jetë 20 cm - xhufka duhet të ketë një unazë metalike bashkuese ngjyrë floriri11 mm të gjerë.	Cope	388

Të dhënat për parametrat cilësor dhe sasior për “Pelerinat për Ceremoni diplomimi për student” janë sipas tabelës nr 2:

Parametrat	Ndarjet			
Përmasa (në gjoks)	S	M	L	XL
Përmasa (në gjatësi)	120	124	128	132
Sasia (në % të totalit të porosisë)	24%	33%	33%	10%

Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare (FMD):

Nr	Emërtimi i Mallit	Njësi	Sasia
1	Pelerina për ceremoni diplomimi për student	Copë	58
2	Kapele me xhufkë për ceremoni diplomimi për student	Copë	58

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Tabela Nr 1

Nr	Përshkrimi i mallrave	Specifikime Teknike	Njësia	Sasia
1	Pelerina për Ceremoni diplomimi për student	- Materiali i pelerinës duhet të jetë atllas 100% poliestër. - Pesha e materialit që do të përdoret duhet të jetë 180 gr/m². - Përmasat duhet të jenë S-M-L-XL (sipas tabelës së mëposhtme Nr 2). - Ngjyra pelerinës do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. - Pelerina duhet të jetë model monopet, pa astar nga brenda dhe përpara të mbyllet me zinxhir. Në bel duhet të jetë e lirshme. Pjesa e përparme të ketë supanjë me copë dopio dhe thellësi 23 cm nga pika më e lartë e supit. Pjesa e përparme të ketë dy pala me gjërësi 5 cm e cila aplikohet tek pjesa e bashkimit me supanjën. Gjithashtu pjesët e përparme, duke filluar nga lart të mbyllen me zinxhirin me dhëmbëza plastike sipas ngjyrës së pelerinës dhe me gjatësi 55-60 cm. - Në të gjithë gjatësinë e saj, pelerina të ketë një imitim shall, i cili e përshkon atë në gjithë gjatësinë e saj. Gjerësia e shallit duhet të jetë 10 cm. Në pjesën e jashtme shalli duhet të qepet në trupin e pelerinës. Në pjesën e pasme shalli duhet të përfundojë me një trekëndësh, me një gjatësi 10 cm nga qepja e jakës. Shalli duhet të jetë i fiksuar në pjesët e përparme të pelerinës me një tegel me një gjilpërë. Ngjyra e shallit duhet të jetë e njëjtë me atë të xhufkës, e cila do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. - Shpinës së pelerinës do t'i aplikohet gjithashtu një supanjë me copë dopio. - Pala e pelerinës në fund, duhet të dalë e mbaruar 2 cm.	Cope	58

		• Shpina, mëngët dhe gjokset, duhe të bashkohen me makinë me syzator. Gjatë procesit të bashkimit duhet bërë kujdes për të mos krijuar diferenca në gjatësinë e gjokseve. • Mëngët duhe të jenë një copëshe dhe bashkimi i tyre me trupin duhet të realizohen duke filluar nga bashkimi i pjesëve të shpinës me gjokset. Bashkimi i tyre (mëngëve) duhet të bëhet me makinë një gjilpërëshe. Për të patur një bashkim të fortë, të ngritur dhe të harkuar bukur të mëngëve me trupin e pelerinës duhet që thellësia e rrethit të sjetullës të përputhet me thellësinë e mëngës. Bashkimi i mëngëve me trupin e pelerinës duhet të jetë simetrik. Bashkimi duhet të bëhet pa rrudha dhe të mos formojë tërheqje. Mëngët duhet të jenë të tilla që të krijojnë lehtësi në përdorim dhe estetikë në paraqitje. Mbylljet e mëngëve dhe e gjoksit me shpinën për një fiksim sa më të mirë të tyre duhet të realizohen me makinë dygjilpërëshe nga ku përfitohet tegel dysh zbukurimi. Mbyllja e pelerinës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe vazhdon me mbylljen e mëngëve. Pelerina e ceremonisë së diplomimit duhet të jetë simetrike në të gjithë elementet e saj. Ajo në model është e njëjtë si për meshkuj ashtu edhe për femra. • Tegelat duhet të jenë të fortë, uniformë, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rregullt dhe të drejtë. Tegelat duhet të jenë të fortë në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë i fortë dhe i njëjtë me ngjyrën e tekstilit të pelerinës me Nm80/2 100%PES.		
2	Kapele me xhufkë për ceremoni diplomimi për studentë	• Materiali i kapeleve të diplomimit për studentët, duhet të jetë material atlas, 100% poliestër. • Pesha e materialit që do të përdoret duhet të jetë 180 gr/m2. • Kapelja duhet të përbëhet me tre elemente:- Syprina që mbulon pjesën e sipërme të kokës së përdoruesit. Përmasat e saj duhet të jenë 25 cm x 25 cm. Në brendësi të tekstilit duhet të futet një material i fortë dhe i lehtë (karton, plastike) me përmasat e mësipërme dhe i mbuluar me qëllim që të ruajë formën e një syprine katërkëndore. – Cilindri, pjesa e cilindrit që rrethon pjesën anësore të kokës në ekstremin e sipërm lidhet me pjesën katërkëndore, ndërsa në ekstremin e poshtëm qepet një llastik i maskuar me tegel, në mënyrë që të jetë e përshtatshme për çdo përmasë të kokës së përdoruesve. Përmasat e cilindrit të kapeles duhet të jenë unike, në proporcion me pjesën katërkëndore (diametër 20 cm, lartësi 12 cm). Bashkimi i tekstilit me materialin e fortë (karton plastike), duhet të jetë në mënyrën më të mirë të mundshme, me ngjitje ose me qepje. – Xhufka, në mes, kapeles i vendoset një buton, i përbërë nga materiali i kapeles, pas të cilit qëndron e lidhur një xhufkë me fije, ngjyra e të cilës do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. • Materiali që do të përdoret për xhufkat do të jetë: - me fije sintetike me trashësi 2 mm - gjatësia e xhufkës do të jetë 22cm - gjatësia e fijes së mbërthimit të xhufkës me kapelen duhet të jetë 20 cm - xhufka duhet të ketë një unazë metalike bashkuese ngjyrë floriri11 mm të gjerë.	Cope	58

Të dhënat për parametrat cilësor dhe sasior për “Pelerinat për Ceremoni diplomimi për student” janë sipas tabelës nr 2:

Tab Nr 2

Parametrat	Ndarjet			
Përmasa (në gjoks)	S	M	L	XL
Përmasa (në gjatësi)	120	124	128	132
Sasia (në % të totalit të porosisë)	15%	38%	37%	10%

PELERINA DHE KAPELE PËR CEREMONI DIPLOMIMI PËR PROFESORË (SENATI AKADEMIK)

Nr	Emërtimi i Mallit	Njësi	Sasia
1	Pelerina për ceremoni diplomimi për profesorë	Copë	21
2	Kapele për ceremoni diplomimi për profesorë	Copë	21

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Materiali që do të shërbejë për prodhimin e pelerinave të profesorit do të jetë:

- material terital 100% poliestër
- pesha 180 gr / m2

Prodhohet dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas masave të gjokseve S, M, L, XL të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht. Ngjyra e pelerinës për profesorët do të jetë e zezë e kombinuar në pjesën përpara në të dy anët e gjoksit me një fashaturë me ngjyrë e cila do të vendoset nga Autoriteti Kontraktor në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Prodhimi i këtij artikulli duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të përcaktuar mbi bazën e kërkesave dhe kushteve teknologjike të sakta në secilën fazë të realizimit të tij.

Prodhimi ndahet në tre faza kryesore të cilat janë:

- Përpunimi përgatitor*, ka të bëjë me kolaudimin e lëndëve të para dhe ndihmëse, skicimin, prerjen në prestari, marketimin dhe kollaritjen e pjesëve përbërëse të pelerinës.
- Konfeksionimi*, ka të bëjë me qepjen e pjesëve përbërëse të pelerinës sipas një procesi linear të përcaktuar. Në faza të ndërmjetme të këtij procesi do të kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysëm produkteve. Në përfundim kryhet dhe hekurosja e produktit të gatshëm.
- Paketimi* ka të bëjë me kontrollin përfundimtar të cilësisë, etiketimin, amblazhimin për çdo produkt dhe paketimin total të gjithë sasisë të produktit të gatshëm dhe përgatitjen e tij për lëvrimin drejt magazinës së përdoruesit.

A. Përpunimi përgatitor:

- a.1. *Skicimi*: Faza e parë për prodhimin e pelerinave është skicimi i tyre me sistemin e programimit linear CAD-CAM, mënyrë kjo e cila siguron një shënim të saktë të prerjeve.
- a.2. *Prerja*: Gjatë procesit të prerjes, dysheku nuk duhet të kalojë 30 fletë në mënyrë që të mos kemi devijime në fijet e fundit të saj.
- a.3. *Marketimi*: Ky proces është shumë i rëndësishëm sepse eliminon qepjen e detajeve të pelerinës me tonalitete të ndryshme, duke siguruar njëtrajtshmëri në ngjyrë të artikullit.
- a.4. *Kollaritja*: Pjesët e pelerinës ku parashikohet kollaritje me flizelinë duhet të bëhen me presë speciale me avull në temperaturë 130°C-140 °C, me shpejtësi 8-10 sek., në presion 2-3 atm. Kollaritja nuk lejohet me shtesa.

B. Konfeksionimi

b.1. *Procesi i Qepjes*: Pelerina si model është monopet, me jakë në formë katrore, me shpinë njëshe. Pelerina nga brenda është pa astar. Pelerina përpara mbyllet me zinxhir plastik deri në mes. Pelerina në bel është e lirshme. Gjokseve të pelerinës përpara tërthorazi, me ulje nga tegeli i bashkimit të supanjës me gjoksin, krijohet dy rrudha të plota.

Në pjesën para, në bashkim të supanjave të gjoksit me pjesën e poshtme të gjokseve në gjatësinë e tyre, pelerina ka një (fashaturë), i cili e përshkron atë në gjithë gjatësinë e saj. Gjerësia e saj (fashaturës) është 10-15 cm. Në pjesën e jashtme shalli përshkruhet nga një file të e hollë me të njëjtën ngjyrë si fashaturat përpara. Në pjesën e pasme shalli përfundon me një kator me vazhdimin e filetos, me të njëjtën ngjyrë si fashatura, me gjatësi 10 cm nga qepja e jakës. Fashatura është e fiksuar në pjesët e përparme të pelerinës me një tegel me një gjilpërë.

Pjesët e përparme duke filluar nga lart dhe deri në mes mbyllen dhe me një zinxhir me dhëmbeza plastike me ngjyrë të zezë me gjatësi 55 – 60 cm.

Shpina e pelerinës si model është një copëshe, ndërsa pjesa e sipërme e shpinës është dy copëshe.

Shpina, mëngët dhe gjokset bashkohen me makinë me syzator dhe këtyre bashkimeve u vendoset një file të me qëllim që të bëhet e mundur mbulimi i këtyre bashkimeve. Gjatë procesit të bashkimit duhet bërë shumë kujdes për të mos krijuar diferenca në gjatësi të gjokseve.

Mëngët janë një copëshe dhe bashkimi i tyre me trupin e pelerinës duhet të realizohet duke filluar nga bashkimi i pjesëve të shpinës me gjokset. Mëngës duke filluar nga bashkimi me supin në një zbritje 19 cm vendosen shirita me gjerësi 6 cm dhe gjatësi 36 cm. Këto shirita në të dy anët përfundojnë në formë trekëndëshi dhe qarkohen me një filet ngjyrë të artë, largësia midis shiritave duhet të jetë 4.5 cm. Sasia e shiritave, e cila përcakton gradën e Profesorëve, do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës.

b.2. *Bashkimi i mëngëve* duhet të bëhet me makinë njëgjilpërëshe. Për të pasur një bashkim të fortë, të ngritur dhe të harkuar bukur të mëngëve me trupin e pelerinës duhet që thellësia e rrethit të sqetullës të përputhet me thellësinë e mëngës.

Bashkimi i mëngëve me trupin e pelerinës duhet të jetë simetrik. Bashkimi duhet të bëhet pa rrudha dhe të mos formojë tërheqje. Aty ku bëhet bashkimi i mëngës me supin, vendoset një llastik me gjerësi 5 cm dhe gjatësi 29 cm me anë të së cilës krijohet një rrudhë e plotë me 7 tegela.

Mbylljet e mëngëve dhe e gjoksit me shpinën për një fiksion sa më të mirë të tyre duhet të realizohen me makinë njëgjilpërëshe nga ku përfitohet tegel zbuturimi.

Mbyllja e pelerinës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe vazhdon me mbylljen e mëngëve.

Pelerina kalon në procesin e pastrimit të penjëve dhe të proceseve përfundimtare.

Pelerina e ceremonisë së diplomimit për Profesorët, duhet të jetë simetrike në të gjithë elementet përbërës të saj.

Pelerina e ceremonisë në model është e njëjtë si për meshkuj ashtu dhe për femra.

Tegelat duhet të jenë të fortë, uniforme, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rregullt dhe të drejtë. Tegelat duhet të jenë të fortë në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Tegelat duhet të jenë të përforsuar në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë i fortë dhe me ngjyrë si ajo e tekstilit me Nm 80/2 , 100 % PES.

Të dhënat për parametrat kryesore cilësore dhe sasiore jepen në tabelën e mëposhtme:

Parametrat	Ndarjet			
Përmasa (në gjoks)	S	M	L	XL
Përmasa (në gjatësi)	120	124	128	132
Sasia (në % te totalit të porosisë)	10	40	35	15

Kapela për profesorët do të përgatitet prej materiali kadife e zezë, 100% poliestër, pesha 160gr/m2. Kapeleja do te jetë katrore.

Ajo përbëhet nga:

Syprina që mbulon pjesën e sipërme të kokës së përdoruesit;

Pjesa e cilindrit që rrethon pjesën anësore të kokës në ekstremin e sipërm lidhet me pjesën katërkëndore ndërsa në ekstremin e poshtëm qepet velkrof i cili bën të mundur zmadhimin dhe zvogëlimin e kapelës sipas përdoruesit. Nga brenda kapela ka astar me vatinë për të krijuar konfort në qëndrim.

Në mes kapelës i vendoset një buton pas të cilit qëndron e lidhur nje xhufkë me fije ngjyra e të cilave percaktohet nga AK pas lidhjes së kontratës.

Materiali që do të përdoret për xhufkat do të jetë:

- me fije sintetike me trashësi 2mm
- gjatësia e xhufkës do të jetë 22cm
- gjatësia e fijes së mbërthimit të xhufkës me kapelen duhet të jetë 20 cm
- xhufka duhet të ketë një unazë bashkuese metalike ngjyrë flori 11 mm të gjerë

PAKETIMI, ETIKETIMI, CILËSIA ETJ.

1. Për kontrollin cilësor në procesin e prodhimit:

Kontrolli cilësor do të kryhet në procesin e prodhimit për të siguruar cilësinë e prodhimit të sasisë së kontraktuar ndërsa kolaudimi i mallit si proces i pavarur do të bëhet mbas dorëzimit të sasisë së kontraktuar në magazinën e porositësit.

2. Etiketimi: Artikujt e kompletuar me të gjithë elementet dekorative dhe shenjat e përcaktuara në këto Specifikime Teknike marketohen qartë me shkrim me anë të një etikete tekstili të qepur në pjesën e brendshme në qendër të bashkimit të kapucit me shpinën dhe që përmban: Emrin e firmës prodhuese dhe vitin e prodhimit.

Poshtë në anë në pjesën e brendshme të bashkimit të gjoksit me shpinën duhet të vendoset një etiketë e veçantë në të cilën shënohen treguesit bazë të lëndës së I-rë tekstil impermeable të përdorur si dhe me shenja konvenciale për trajtimin e pelerinës hekurosje, larje etj. Pelerina duhet të jetë e pastruar mirë nga penjtë dhe të mos ketë njolla.

3. Paketimi i artikujve: Paketimi i artikujve të mësipërm bëhet duke e palosur dhe futur brenda në qese PVC-je transparente, si për pelerinat e kapelet. Pelerinat e paketuara futen në kuti kartoni. Në çdo kuti duhet të vendosen artikuj të një numri dhe fraksioni prerje. Kutitë duhet të jenë të rregullta dhe të shiritizohen duke siguruar mbyllje të mirë. Mbi kutitë vendosen etiketa ku shënohet qartë emri i firmës prodhuese me vulën përkatëse, sasia dhe viti i prodhimit.

4. *Transporti:* Transporti i artikujve të mësipërm deri në magazinat e AK do të bëhet me mjete të përshtatshme nga Kontraktuesi, në mënyrë që të mos cënohet cilësia e mallit gjatë transportit.

NJËSIA E PROKURIMIT: